

## CFARË ËSHTË FONDI I PENSIONIT PRIVAT?

Fondi i pensionit privat është një plan kursimi dhe një mënyrë e zgjuar për të investuar sot për të pasur të ardhura shtesë në moshën e pensionit.

Ligji Nr. 76/2023 për "Për fondet e pensionit privat" krijon premisa drejt sigurimit të një të ardhme financiare më të mirë dhe më të qëndrueshme për qytetarët. Duke rregulluar krijimin dhe menaxhimin e fondeve të pensionit privat, ky ligj kontribuon në rritjen e mirëqënies dhe sigurisë për individët gjatë periudhës së pensionit.



# FONDET E PENSIONIT PRIVAT - ALTERNATIVË PËR TË SIGURUAR TË ARDHMEN!



## TË ARDHURAT NË PENSION- PËRFITONI MAKSIMALISHT

Kur të vijnë ditët e daljes në pension, ju do të përfitoni jo vetëm pensionin shtetëror, por edhe një shumë shtesë nga fondi juaj i pensionit privat. Kontributet e paguara nga ju dhe punëdhënësi juaj janë të zbritshme nga të ardhurat personale, për efekt tatimi, deri në nivelin e pagës minimale.

# Pyetje të Shpeshta

## Kush mund të kontribuojë në një fond pensioni privat?

Çdo individ me të ardhura të rregullta, përfshirë të punësuarit dhe të vetëpunësuarit, mund të kontribuojë në një fond pensioni privat.

## A janë të sigurta fondet e pensionit privat?

Fondet e pensionit privat administrohen nga shoqëri të licencuara dhe të mbikëqyrura nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare.

## Si ndikon inflacioni në fondin tim të pensionit?

Fondet e pensionit privat investojnë në instrumente financiare që synojnë të ofrojnë kthime që kompensojnë në një masë të caktuar efektet e inflacionit, duke ruajtur vlerën reale të kursimeve tuaja.

## Çfarë ndodh me kontributet e mia nëse ndërroj punëdhënës?

Kontributet që keni paguar në fondin e pensionit privat janë tuajat dhe mund t'i transferoni në çdo kohë. Kontributet e paguara nga punëdhënësi, do të kalojnë në emrin tuaj pasi të përfundojë afati i përcaktuar në kontratën që keni nënshkruar.

## Si mund të filloj të investoj?

Për të filluar, kontaktoni një shoqëri administruese të licencuar që ofron fonde pensioni privat, plotëson dokumentacionin e nevojshëm dhe filloni të paguani kontributet tuaja rregullisht cdo muaj.

## INFORMACIONI

Për të marrë më shumë informacion si të investoni në një fond pensioni privat, kontaktoni shoqritë e licencuara dhe filloni të ndërtoni një të ardhme më të sigurt financiare.